

Tiranë, më 7 korrik 2026

Drejtuar: Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI)
LËNDA: Komente dhe rekomandime në kuadër të konsultimit publik për
"Projekt-Strategjinë Kombëtare Industriale (SKI) 2026–2030"

I nderuar Zëvendësministër Kajo,

ICC Albania, si organizatë përfaqësuese e sektorit të biznesit, mirëpret nismën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit për hartimin e Projekt-Strategjisë Kombëtare Industriale (SKI) 2026–2030 dhe mundësimin e komenteve si pjesë e procesit të konsultimit publik mbi këtë dokument.

Në vijim të angazhimit tonë në këtë proces, po ju përcjellim me anë të kësaj shkrese komentet dhe vërejtjet tona mbi projekt-strategjinë, me qëllim përmirësimin e cilësisë, koherencës dhe zbatueshmërisë së dokumentit final.

Komentet janë strukturuar sipas katër aspekteve kryesore të vlerësimit: përafrimi me legjislacionin e BE-së, përputhja me Aktin për Përshpejtimin Industrial (IAA), këndvështrimi i biznesit si dhe plotësia, thjeshtësia dhe kohezioni i brendshëm i dokumentit.

1. Përmbledhje e vlerësimit të përgjithshëm

Projekt-Strategjia Kombëtare Industriale 2026–2030 paraqitet si një dokument teknikisht i avancuar, i strukturuar rreth katër qëllimeve strategjike dhe i lidhur me instrumente ekzistuese kombëtare dhe kornizën e *acquis* të BE-së, veçanërisht Kapitullin 20.

Megjithatë, në raport me aspektet e vlerësimit, dokumenti paraqet disa boshllëqe kryesore që lidhen me:

- përafrimin më të plotë me *acquis*
- mungesën e operacionalizimit të plotë të disa kuadreve të BE-së (veçanërisht IAA),
- mungesën e disa elementeve financiare dhe sociale të zbatimit,
- si dhe disa paqartësi strukturore dhe editoriale.

Nga këndvështrimi i biznesit, strategjia lë pa trajtuar mjaftueshëm disa dimensione kyçe për zbatueshmërinë praktike si; dialogun e vazhdueshëm publik-privat, financimin privat, energjinë, aftësitë profesionale, informalitetin dhe integrimin rajonal.

2. Përafrimi me *acquis*të BE-së

Konstatim: Dokumenti pasqyron një përpjekje të qartë dhe sistematike për përafrim me kuadrin ligjor dhe politik të Bashkimit Evropian:

- Strategjia referon në mënyrë të vazhdueshme Kapitullin 20 të *acquis* "NVM-të dhe Politikat Industriale" si kornizën udhëheqëse, duke përdorur një matricë të dedikuar përputhshmërie që lidh objektivat specifike me kapitujt përkatës të *acquis* (Kapitujt 20, 25, 27, 2 dhe 19).
- Janë integruar në mënyrë eksplicite instrumente dhe akte kyçe të BE-së, përfshirë CBAM – Rregullorja (BE) 2023/956, Aktin e Industrisë Neto-Zero (NZIA) – Rregullorja (BE) 2024/1735, Direktivat RED III, si dhe komunikatat strategjike COM(2020)102 dhe COM(2021)350 mbi politikën e re industriale të BE-së.
- Dokumenti adopton taksonominë e 14 ekosistemeve industriale të BE-së si kornizë referuese për identifikimin e ekosistemeve prioritare kombëtare, duke rritur krahasueshmërinë me raportimin dhe monitorimin e BE-së.
- Objektivat strategjike janë të lidhur gjithashtu me shtyllat përkatëse të Marrëveshjes së Stabilizim–Asociimit (MSA), përfshirë Titullin V (lëvizja e lirë e mallrave), Titullin VI (përafrimi i legjisllacionit) dhe Titullin VIII (bashkëpunimi sektorial).

Vlerësim: Në tërësi, pika e fortë e këtij dokumenti qëndron te ekzistenca e matricave të strukturuar të përputhshmërisë, e cila mundëson lidhje të drejtpërdrejtë midis objektiveve dhe kuadrit të BE-së, duke e bërë dokumentin të gjurmueshëm dhe teknikisht të krahasueshëm.

► Hapësira dhe fusha për përmirësim

Konstatim: Pavarësisht nivelit të mirë të përafrimit me *acquis* ekzistues, identifikohen disa boshllëqe të rëndësishme:

- Referencat aktuale mbulojnë kryesisht legjisllacionin e miratuar deri në vitin 2024 (p.sh. NZIA, CBAM, RED III), ndërsa zhvillimet më të fundit dhe në proces (2025–2026), si Akti për Përshtetimin Industrial (IAA), rishikimi i kuadrit për kontrollin e IHD-ve dhe nisma të tjera "Environmental Omnibus", trajtohen në mënyrë të kufizuar dhe jo analitike.
- Matrica e përputhshmërisë me *acquis* (Tabela 3) mbulon vetëm një pjesë të kufizuar të kapitujve (20, 25, 2, 19 dhe 27), duke lënë jashtë fusha me rëndësi të lartë për zbatimin industrial, veçanërisht:
 - Kapitullin 7 (E drejta e pronësisë intelektuale),
 - Kapitullin 8 (Politika e konkurrencës),
 - Kapitullin 28 (Mbrotjtja e konsumatorit dhe shëndetit).

- Mungon një lidhje më eksplicite midis instrumenteve industriale dhe rregullave të ndihmës shtetërore dhe konkurrencës, çka është thelbësore për të shmangur shtrembërime të tregut në fazën e dizenjimit të politikave.
- Nuk parashikohet një mekanizëm i qartë për përditësimin periodik (review clause) të matricës së *acquis*, duke kufizuar fleksibilitetin e strategjisë për të reflektuar zhvillimet e reja legjislative të BE-së.

Vlerësim: Pavarësisht bazës së mirë ekzistuese, kuadri i përafrimit mbetet pjesërisht jo i plotë në aspektin e thellësisë analitike dhe përditësimit dinamik të *acquis*.

Rekomandim: Të zgjerohet matrica e *acquis* për të përfshirë kapitujt e munguar dhe të forcohet lidhja me rregullat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore. Gjithashtu, të vendoset një mekanizëm formal rishikimi periodik (review clause) (p.sh. çdo 12–24 muaj) për përditësimin e matricës në funksion të zhvillimeve të reja të BE-së, përfshirë IAA dhe instrumente të tjera në zhvillim.

3. Përputhshmëria me Akti për Përsheptimin Industrial (Industrial Accelerator Act – IAA)

Konstatim: Akti për Përsheptimin Industrial ([Industrial Accelerator Act – IAA](#)¹), i propozuar nga Komisioni Evropian më 4 mars 2026 (COM(2026)100), synon forcimin e konkurrueshmërisë industriale të Bashkimit Evropian dhe rritjen e peshës së industrisë në 20% të PBB-së së BE-së deri në vitin 2035.

Aktualisht, akti ndodhet në procedurën e zakonshme legjislative dhe përbën ende një propozim, jo legjislacion të miratuar. Ky element do të ishte i dobishëm të qartësohej në mënyrë eksplicite edhe në vetë strategjinë, kur ai referohet.

Akti ka katër shtylla kryesore:

- kërkesa origjine/karboni të ulët “Made in EU” në prokurim publik dhe skema mbështetëse;
- kontroll i ri i investimeve të huaja direkte mbi 100 milionë € nga vende me mbi 40% të kapacitetit global prodhues në sektorë strategjikë;
- “zona të përsheptimit të prodhimit industrial” me leje bazë të parapërgatitur; dhe
- thjeshtim i procedurave të lejeve, përmes dritares së vetme digjitale.

Nga analiza e Projekt-Strategjisë Kombëtare Industriale (SKI) rezulton se referimi ndaj IAA është i kufizuar dhe kryesisht i tërthortë. Akti përmendet vetëm në dy raste: (i) si element frymëzimi për hartimin e një “Ligji për Zhvillimin e Politikave Industriale” (masa 1.1.4), dhe (ii) në tabelën e masave prioritare (4). Megjithatë, nuk ka një analizë të strukturuar të përmbajtjes së aktit dhe as të implikimeve të tij për ekonominë shqiptare dhe procesin e përafrimit me politikat industriale të BE-së.

¹ COM(2026)100 – Propozim për Rregullore për krijimin e një kuadri masash për përsheptimin e kapaciteteve industriale dhe dekarbonizimin në sektorët strategjikë (Akti për Përsheptimin Industrial – Industrial Accelerator Act). Aksesuar: https://single-market-economy.ec.europa.eu/publications/industrial-accelerator-act_en#details

Tabela më poshtë krahason katër shtyllat e IAA-s me trajtimin aktual në SKI:

Shtylla e IAA	Përmbajtja kryesore e IAA	Trajtimi në SKI (draft)	Hendek / Rekomandim
1. Preferenca „Made in EU“ / karboni i ulët në prokurim publik	Kërkesa origjine dhe intensiteti karboni për çelik, çimento, alumin, automjete elektrike etj. në prokurime dhe skema mbështetëse publike.	Prokurimi publik si instrument industrial përmendet vetëm në parim (OS 1.1, masa 1.1.4); s'ka analizë të ekspozimit të furnitorëve shqiptarë ndaj kriterëve të origjinës/karbonit të BE-së.	Të përfshihet një nën-objektiv/masë që analizon ekspozimin e industrisë shqiptare ndaj kërkesave të origjinës dhe karbonit në zinxhirët e furnizimit të BE-së, si dhe të parashikohen hapa për ndërtimin e kapaciteteve të certifikimit dhe përputhshmërisë.
2. Kontrolli i investimeve të huaja direkte (FDI screening, >100 mln €, >40% e kapacitetit global)	IAA parashikon një regjim të ri kontrolli për investimet e huaja mbi 100 milionë euro në sektorë strategjikë, veçanërisht nga vende me peshë të lartë në kapacitetin global të prodhimit.	SKI nuk e trajton këtë dimension. Strategjia fokusohet vetëm në diversifikimin e IHD-ve si tregues rezultati, pa analizuar ndikimin e mundshëm të regjimit të ri të BE-së mbi flukset e investimeve në Shqipëri dhe në rajon. (OS 2.1, treguesi 8)	Të shtohet një referencë analitike mbi implikimet afatgjata të regjimit FDI për sektorët industrialë shqiptarë, veçanërisht në industri të avancuara.
3. Zonat e Përsheptimit të Prodhimit Industrial (Industrial Manufacturing Acceleration Areas-IMAA)	IAA parashikon krijimin e zonave të dedikuara industriale me leje të parapërgatitura dhe procedura të thjeshtuara administrative (one-stop-shop), për të përsheptuar investimet industriale. Çdo shtet anëtar cakton të paktën një zonë me leje bazë të parapërgatitur për grumbullimin e investimeve industriale.	SKI trajton zonat industriale dhe klasterat në kuadër të Qëllimit Strategjik 4, por pa i lidhur ato me konceptin specifik të IAA-së dhe standardizimin e procedurave të lejeve.	Të krijohet lidhje eksplicite mes zonave/parqeve industriale ekzistuese (OS 4.x) dhe modelit IMAA, si përgatitje për përafrim të ardhshëm dhe si mundësi konkurrimi për fonde/partneritete BE.
4. Thjeshtimi i lejeve (dritare e vetme digjitale, afat 45-ditor për kompletimin e aplikimit)	IAA vendos standarde të reja për thjeshtimin e lejeve industriale, përfshirë krijimin e një dritareje të vetme digjitale dhe afate të	Digjitalizimi dhe thjeshtimi rregullator përmenden në disa objektiva (p.sh. OS 1.3, OS 4.1) por si parime të përgjithshme, jo si përafrim me standardin konkret	Të përfshihen afate dhe standarde konkrete (të ngjashme me IAA/NZIA) në masat për lejet industriale, në vend të gjuhës së përgjithshme.

Shtylla e IAA	Përmbajtja kryesore e IAA	Trajtimi në SKI (draft)	Hendek / Rekomandim
	përcaktuara kohore për trajtimin e aplikimeve.	kohor/procedural të IAA-s.	

Në tërësi, SKI reflekton orientim të përgjithshëm drejt politikave të reja industriale të Bashkimit Evropian, por nuk e integron në mënyrë sistematike arkitekturën e propozuar nga IAA. Kjo krijon një hendek analitik në lidhje me përafrimin afatmesëm me zhvillimet më të fundit të politikës industriale të BE-së.

4. Fusha shtesë me vlerë nga këndvështrimi i biznesit

Ky seksion paraqet një vlerësim plotësues nga këndvështrimi i komunitetit të biznesit, duke u fokusuar në elementet që ndikojnë drejtpërdrejt në zbatueshmërinë praktike të Strategjisë Kombëtare Industriale (SKI) 2026–2030.

- **Dialog i strukturuar publik-privat:** Strategjia parashikon konsultim në fazën e hartimit, por jo një mekanizëm të përhershëm institucional (p.sh. këshill konsultativ periodik biznes-qeveri sikurse Këshilli i Investimeve) për monitorimin e zbatimit gjatë gjithë periudhës 2026–2030.

Vlerësim: Mungesa e një strukture të formalizuar rrezikon të kufizojë efektivitetin e monitorimit dhe përshtatjes së politikave në kohë reale.

Rekomandim: Të krijohet një këshill konsultativ publik–privat me pjesëmarrjen e organizatave përfaqësuese të biznesit ose të delegohet si kompetencë pranë Këshillit të Investimeve, i cili të mbledhet periodikisht për të shqyrtuar progresin e zbatimit dhe për të sinjalizuar pengesat operacionale.

- **Vlerësimi i ndikimit rregullator (RIA):** Shumë masa parashikojnë detyrime të reja (certifikime, raportime, standarde) pa një vlerësim sasior të kostos administrative /financiare për kompanitë.

Vlerësim: Mungesa e analizës së ndikimit rregullator e vështirëson vlerësimin e barrës administrative mbi bizneset, veçanërisht mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

Rekomandim: Të institucionalizohet aplikimi i Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA) për çdo masë me efekt të drejtpërdrejtë mbi bizneset, në bashkëpunim me organizatat përfaqësuese të sektorit privat.

- **Financimi dhe mobilizimi i kapitalit privat:** Strategjia fokusohet kryesisht te burimet publike (buxhet shtetëror, IPA III, donatorë), por trajton në mënyrë të kufizuar instrumentet që mobilizojnë kapitalin privat.

Vlerësim: Ky fokus i ngushtë mund të kufizojë aftësinë e strategjisë për të gjeneruar investime të mjaftueshme për transformimin industrial.

Rekomandim: Të përfshihen instrumente të dedikuara për mobilizimin e kapitalit privat, përfshirë garanci kredie, fonde të kapitalit të rrezikut (venture capital) dhe skema bashkëfinancimi publike–private.

- ▶ **Energjia dhe konkurrueshmëria industriale:** Konkurrueshmëria industriale varet drejtpërdrejt nga çmimi dhe stabiliteti i energjisë, veçanërisht në kontekstin e dekarbonizimit dhe CBAM-it.

Vlerësim: Strategjia e trajton energjinë në mënyrë të përgjithshme, pa analizë të detajuar të ndikimit të kostove të energjisë në industrinë prodhuese.

Rekomandim: Të përfshihet një analizë e dedikuar mbi ekspozimin e industrisë shqiptare ndaj çmimeve të energjisë, si dhe masa konkrete për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe konkurrues.

- ▶ **Aftësitë profesionale dhe fuqia punëtore:** Mospërputhja mes arsimit e formimit profesional (AFP) dhe kërkesave reale të industrisë, si dhe emigrimi i vazhdueshëm i fuqisë punëtore të kualifikuar, përbëjnë pengesë themelore për çdo strategji industriale.

Vlerësim: Strategjia nuk e trajton në mënyrë të integruar lidhjen midis politikave industriale dhe sistemit të arsimit dhe formimit profesional.

Rekomandim: Të forcohet lidhja me Strategjinë e Punësimit dhe reformat e arsimit profesional (AFP), duke përfshirë tregues të përbashkët të performancës dhe mekanizma bashkëpunimi me industrinë.

- ▶ **Formalizimi i ekonomisë:** Një pjesë e konsiderueshme e ndërmarrjeve të vogla shqiptare operojnë pjesërisht ose plotësisht jashtë ekonomisë formale, çka i përjashton nga shumica e instrumenteve mbështetëse (grante, certifikime, prokurim publik).

Vlerësim: Kjo krijon një boshllëk në mbështetjen e industrisë për adoptimin e teknologjive të avancuara.

Rekomandim: Të krijohet një masë e dedikuar për mbështetjen e transformimit digjital të NVM-ve industriale, përfshirë automatizimin, planifikim i burimeve të ndërmarrjes - ERP, teknologjitë Industry 4.0 dhe sigurinë kibernetike.

- ▶ **Digjitalizimi i vetë ndërmarrjeve** (jo vetëm i administratës): Strategjia thekson digjitalizimin e shërbimeve publike, por trajton në mënyrë të kufizuar mbështetjen konkrete për transformimin digjital të ndërmarrjeve prodhuese (automatizim, ERP, siguri kibernetike, teknologji Industry 4.0).

Vlerësim: Kjo krijon një boshllëk në mbështetjen e industrisë për adoptimin e teknologjive të avancuara.

Rekomandim: Të krijohet një masë e dedikuar për mbështetjen e transformimit digjital të NVM-ve industriale, përfshirë automatizimin, ERP, teknologjitë Industry 4.0 dhe sigurinë kibernetike.

- **Integrimi rajonal dhe CEFTA:** Strategjia fokusohet gati ekskluzivisht te integrimi me tregun e BE-së, por trajton në mënyrë minimale mundësitë dhe rreziqet nga zinxhirët rajonalë të furnizimit dhe tregu i CEFTA-s, partner tregtar potencial dhe i arritshëm për shumë ndërmarrje shqiptare.

Vlerësim: Mungon një analizë e plotë e rolit të tregut rajonal si hap ndërmjetës drejt integritit evropian.

Rekomandim: Të përfshihet një analizë e dedikuar mbi pozicionimin e industrisë shqiptare në zinxhirët rajonalë të vlerës në kuadër të CEFTA-s, paralelisht me përgatitjen për integrim në tregun e BE-së.

5. Komente editoriale dhe teknike të SKI-së

Më poshtë po sjellim një vlerësim të elementeve teknike, editoriale dhe të teknikës legislative të projekt-strategjisë, të cilat ndikojnë në cilësinë formale, lexueshmërinë dhe koherencën e dokumentit.

- **Konsistenca e terminologjisë institucionale:** Në dokument vërehen mospërputhje në përdorimin e akronimit “MEI”, i cili paraqitet me emërtime të ndryshme:

- “Ministria e Ekonomisë dhe Industrisë” (Lista e shkurtimeve)
- “Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit” (kapitulli i zbatimit)
- “Ministria përgjegjëse për Ekonominë” (tabelat e treguesve)

Vlerësim: Këto mospërputhje krijojnë paqartësi institucionale dhe dobësojnë koherencën e dokumentit.

Rekomandim: Të unifikohet emërtimi zyrtar i institucionit në të gjithë dokumentin dhe të përcaktohet një version i vetëm në listën e shkurtimeve.

- **Akronimet dhe përkufizimet:** Në disa pjesë të dokumentit përdoren akronime që nuk janë të përfshira në listën e shkurtimeve (p.sh. MBZHR, MTKS), ndërsa të tjera përkufizohen në mënyrë jo të plotë.

Vlerësim: Mungesa e një standardi të qartë për akronimet krijon vështirësi në lexim dhe interpretim, veçanërisht për palët joteknike.

Rekomandim: Të sigurohet që çdo akronim të përkufizohet në përdorimin e parë dhe të përfshihet në mënyrë të detyrueshme në listën e shkurtimeve.

- ▶ **Gabime drejtshkrimore dhe teknike:** Janë identifikuar disa gabime drejtshkrimore dhe teknike, përfshirë “*Acquis Communautaire*” në vend të “*Communautaire*” etj.

Vlerësim: Këto gabime ndikojnë në cilësinë formale të dokumentit dhe krijojnë përshypje të mungesës së finalizimit editorial.

Rekomandim: Të kryhet një rishikim i plotë gjuhësor dhe teknik përpara miratimit final.

- ▶ **Konsistenca e referencave dhe lidhjeve:** Në seksionin mbi Kapitullin 20 të *acquis* vërehen referenca dhe hiperlinke të paplotësuara ose jofunksionale.

Vlerësim: Referencat e paplotësuara dobësojnë besueshmërinë teknike të dokumentit dhe kufizojnë verifikueshmërinë e burimeve.

Rekomandim: Të verifikohen dhe korrigjohen të gjitha hiperlinket dhe referencat ligjore përpara publikimit të dokumentit.

- ▶ **Strukturimi i tabelave dhe numërtimi:** Vërehen probleme në numërtimin e tabelave dhe strukturimin e tyre, përfshirë përdorimin e përsëritur të etiketimeve identike (“Tabela 2”) në seksione të ndryshme.

Vlerësim: Ky problem dëmton referencimin e brendshëm dhe krijon paqartësi në leximin teknik të dokumentit.

Rekomandim: Të aplikohet një sistem unik dhe sekuencial numërtimi për të gjitha tabelat dhe figurat në dokument.

- ▶ **Koherenca stilistike dhe gjuha:** Stili i dokumentit karakterizohet nga përdorim i dendur i gjuhës burokratike dhe fjalive të gjata, me strukturë të ndërlikuar sintaksore.

Vlerësim: Edhe pse gjuha është teknikisht korrekte, ajo redukton lexueshmërinë për palët joteknike dhe e bën dokumentin më pak të aksesueshëm në konsultimin publik.

Rekomandim: Të thjeshtohet stili gjuhësor, duke preferuar fjali më të shkurtra, strukturë më të drejtpërdrejtë dhe reduktim të nominalizimeve të panevojshme.

- ▶ **Vlerësim i përgjithshëm i cilësisë editoriale**

Në tërësi, dokumenti paraqet një strukturë të avancuar teknike, por kërkon përmirësime në nivel editorial dhe të standardizimit të elementeve formale për të arritur një nivel të plotë finalizimi.

6. Rekomandime të përmbledhura, sipas prioritetit

Prioritet kryesor

1. **Të zgjerohet dhe thellohet përfrimi me *acquis* të BE-së** (përfshirë kapitujt e munguar dhe rregullat e konkurrencës) dhe të qartësohet trajtimi i IAA si akt në proces.

2. **Të sigurohet koherenca e brendshme e strategjisë** (objektiva, matrica, TeP, tregues që mungojnë).
3. **Të institucionalizohet RIA** për të gjitha masat me ndikim mbi biznesin dhe të përcaktohet kosto reale për NVM-të.
4. **Të krijohet mekanizëm i përhershëm dialogu publik–privat** për monitorim të zbatimit.
5. **Të qartësohet metodologjia e kostimit dhe burimet e financimit** të masave.

Prioritete për forcimin e zbatimit

6. **Të forcohen instrumentet e financimit privat** (garanci, VC, PPP).
7. **Të analizohet ndikimi i kostos së energjisë** në konkurrueshmërinë industriale.
8. **Të integrohet më fort arsimi profesional** (AFP) me nevojat e industrisë.
9. **Të adresohen informaliteti dhe formalizimi progresiv** i ndërmarrjeve.
10. **Të mbështetet transformimi digjital** i NVM-ve (Industry 4.0).
11. **Të përfshihet dimensionin rajonal** (CEFTA) në analizën e zinxhirëve të vlerës.

Masa plotësuese

12. **Përmirësim editorial dhe teknik** (terminologji, akronime, gabime, linke).
13. **Standardizim i tabelave**, numërtimit dhe strukturës së dokumentit.
14. **Thjeshtim i gjuhës** dhe shtim i një versioni të shkurtuar për publikun.

ICC Albania mbetet e angazhuar për të kontribuar në mënyrë konstruktive gjatë fazave të mëtejshme të këtij procesi dhe mbetet në dispozicion për çdo sqarim teknik, diskutim apo bashkëpunim të nevojshëm për përmirësimin e dokumentit përfundimtar.

Me respekt,



Ardita Seknaji

Sekretar i Përgjithshëm